



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT GJENERAL/KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA  
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. i dok. 24.31.9-2007-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT MBI RISHIKIMIN E PROCESIT  
TË LICENSIMIT NË KPMM RRETH LICENSAVE TË  
DRAZHNJES DHE CRPULJES**

**Prishtinë, Prill 2008**

## **Tabela e përmbajtjes**

I.	Lista e shkurtesave dhe akronimeve	4
II.	Përmbledhja e përgjithshme	5
III.	Historiku	6
IV.	Objektivi i auditimit dhe fushëveprimi i rishikimit	7
V.	Të gjeturat e auditimit	8
	1. Licenca e Drazhnjes	8
	2. Licenca e Crpuljes	10
	3. Të gjeturat rreth licencave të Drazhnjes dhe Crpuljes	12
VI.	Konkluzioni	13
VII.	Rekomandimet	14
VIII.	Komentet e menaxhmentit dhe vlerësimi ynë	15

## **I. Lista e shkurtesave dhe akronimeve**

<b>Rregullorja 2005/2</b>	Rregullorja e UNMIK-ut “mbi themelimin e Komisionit për Miniera dhe Minerale”
<b>Rregullorja 2005/3</b>	Rregullorja e UNMIK-ut “mbi minierat dhe mineralet”
<b>ZPSSP</b> Përgjithshëm	Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të
<b>SIGJ</b>	Sistemi i Informacionit Gjeografik
<b>KPMM</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
<b>KR sh.p.k</b>	Kosovo Resources Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
<b>AKM</b>	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
<b>MEM</b>	Ministria e Energjisë dhe Minierave
<b>PMBM</b>	Plani për Menaxhimin e Burimeve Minerare
<b>NPSH</b>	Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore
<b>PSSP</b>	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

## II. Përmbledhje e përgjithshme

Kemi bërë një rishikim të procesit administrativ të ndërlidhur me licensat për Eksplorim të Drazhnjes dhe Crpuljes që Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në vitin 2006 dhe 2007 ia ka dhënë Kompanisë “Kosovo Resource sh.p.k.” (KR sh.p.k.). Kjo e fundit është vartëse e Lydian Resource Company Ltd, një kompani e regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar që merret me eksplorimin dhe shfrytëzimin mineral.

Objektivat tanë kryesorë ishin që të vërtetonim nëse lëshimi i këtyre dy licencave të eksplorimit nga KPMM është bërë në pajtim me Rregulloren 2005/3 “mbi Minierat dhe Minerale në Kosovë”, nëse aplikacionet për këto dy licenca kanë qenë të mbështetura me dokumentacion adekuat dhe me tarifën e përcaktuar, nëse proceset e licencimit janë bërë në mënyrë të drejtë dhe transparente pa ndonjë indikacion për influencim të papërshtatshëm mbi proceset e licencimit si dhe të vlerësonim nëse bëhet fjalë për konflikt interesi të dyshuar rreth postit të një ish anëtari të bordit të KPMM-së, i cili ka pranuar një post nga i licencuari në vitin 2007.

Të gjeturat tona konkludojnë se Qarkorja që është përdorur në procesimin administrativ të kërkesës për licencë jo gjithmonë përmban datën e nënshkrimit nga të gjitha departamentet relevante dhe nuk e identifikon qartë se kur departamentet përkatëse i kanë përmbyllur hapat e tyre të procesit për shqyrtimin e aplikacionit. Më tej, KPMM-së i mungon një përshkrim i detajuar dhe gjithëpërfshirës i të gjithë hapave të procesit administrativ që duhet të ndërmerren që nga momenti i marrjes së një aplikimi deri në momentin e lëshimit të licencës. Sipas të kuptuarit tonë KPMM-së ende i mungon një manual administrativ në të cilin do të përshkruheshin hollësisht të gjitha proceset kyçe si ato financiare, administrative, të rekrutimit të stafit, të licencimit etj.

Ne konkludojmë se proceset e licencimit të Drazhnjes dhe Crpuljes janë realizuar si çështje të praktikës së zakonshme të KPMM-së. Aplikimet janë bërë në pajtim me Neni 21 të Rregullores 2005/3 dhe aplikuesi KR sh.p.k. ka paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Anëtarët e Para-Bordit i kishin dhënë rekomandim pozitiv Bordit Drejtues për të dyja rastet dhe Bordi Drejtues kishte marrë vendime unanime për dhënien e këtyre licencave. Mbledhja e Para-Bordit thirret nga pjesëtarët e stafit të KPMM-së të disiplinave përkatëse teknike dhe në të nuk përfshihen anëtarët e Bordit Drejtues me të drejtë vote. Nuk ka pasur bazë për të konstatuar si të vërteta pretendimet se këto procese të licencimit kanë qenë të njëanshme dhe të manipuluar në favor të kompanisë KR sh.p.k., po ashtu nuk kemi gjetur indikacione për ndonjë favoritizëm të dyshuar.

### **III. Historiku**

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/2 si një organ i pavarur rregullator për kontrollimin dhe monitorimin e industrisë së shfrytëzimit mineral në Kosovë. Komisioni udhëhiqet nga Bordi Drejtues i përbërë nga 5 anëtarë, 3 nga të cilët emërohen nga PSSP-ja mbi bazë të rekomandimit të ZPSSP-së për Rindërtim Ekonomik si dhe 2 anëtarë të tjerë emërohen nga PSSP-ja mbi bazë të rekomandimit të Qeverisë dhe pas miratimit nga Kuvendi.

Në kryerjen e detyrave të saj, KPMM zbaton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/3 "mbi Minierat dhe Mineralet në Kosovë".

### **IV. Objektivi i auditimit dhe fushëveprimi i rishikimit**

Kemi bërë një rishikim të procesit administrativ të ndërlidhur me licensat e Drazhnjes dhe Crpuljes për eksplorim që Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ia ka dhënë "Kompanisë Kosovo Resource sh.p.k." (KR sh.p.k) në vitin 2006 dhe 2007. Kjo e fundit është vartëse e Lydian Resource Company Ltd, një kompani e regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar që merret me eksplorimin dhe shfrytëzimin mineral.

Objektivat tanë kryesorë ishin që të:

- Vërtetohet nëse këto dy licensa eksplorimi janë lëshuar nga KPMM në pajtim me Rregulloren 2005/3 "mbi Minierat dhe Mineralet në Kosovë."
- Vërtetohet nëse aplikimet për këto licensa kanë qenë të mbështetura me dokumentacion adekuat dhe më tarifën e përcaktuar si kërkohet me Rregulloren 2005/3.
- Vërtetohet nëse proceset e licencimit janë bërë në mënyrë të drejtë dhe transparente pa ndonjë indikacion për influencim të papërshtatshëm mbi procesin e licencimit, si dhe të vlerësonim nëse bëhet fjalë për konflikt interesi të dyshuar në lidhje me postin e një ish anëtari të bordit të KPMM-së, i cili kishte pranuar një post nga i licencuari në vitin 2007
- Vlerësohet posti i dyshuar për konflikt interesi i një ish anëtari të bordit të KPMM-së, i cili ka pranuar një post nga i licencuari në vitin 2007 dhe të shqyrtohet nëse ka bazë të arsyeshme për të pretenduar së konflikti i interesit me të vërtetë ka ndodhur dhe nëse do të ekzistonte rreziku që procesi i licencimit të mund të influencohej në mënyrë të papërshtatshme si rezultat i kësaj.

- Vlerësohet çfarëdo deklarate tjetër që pretendon se procedurat administrative do të mund të jenë shkelur dhe të vlerësohet nëse këto shkelje do të justifikonin anulimin e licencës (licencave).

Për realizimin e këtij rishikimi kemi shfrytëzuar dokumentacionin në vijim:

1. Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit në të cilat është dhënë miratimi për këto licenca.
2. Dokumentacioni mbështetës i dorëzuar me aplikacionet.
3. Dokumentet e Para-Bordit të cilat paraqesin nënshkrimet e stafit që ka marrë pjesë në shqyrtimin e dokumentacionit të licencës dhe që ka qenë përgjegjës për inspektimet në terren. Para-Bordi i përbërë prej pjesëtarëve të stafit të KPMM-së të fushave të ndryshme relevante profesionale rekomandon lëshimin e licencës mbi
4. bazë të cilit anëtarët e Bordit të KPMM-së mundën pastaj ta miratojnë këtë rekomandim apo të vënë në dyshim rekomandimin.
5. Dokumentacion tjetër që mbështet aktivitetet dhe vlerësimet e bëra nga stafi përkatës pjesë e Para-Bordit në procesin që ka çuar drejt rekomandimit pozitiv për lëshimin e këtyre licencave.
6. Korrespondencën nga Trepça në lidhje me licencën e Crpuljes (letra më datë 14/09/07).
7. Transkripti i diskutimeve të Kuvendit mbi licencën e Drazhnjes më 21/06/07 (përkthim i shkurtër në anglisht i temave kryesore dhe deklaratave/argumenteve të paraqitura).
8. Rregullorja e UNMIK-ut 2005/3.

## V. Të gjeturat e auditimit

### 1. Licenca e Drazhnjes

Aplikacioni është marrë më 6 shkurt 2006. Tarifa e përcaktuar është paguar përmes një banke lokale bashkë me dokumentacionin e kërkuar sipas Nenit 21 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/3.

Më 10 maj 2006, ekspertët e KPMM-së në mbledhjen e Para-Bordit vendosën që t'i rekomandonin Bordit të KPMM-së lëshimin e kësaj licence. Mbledhja e Para-Bordit ka pasur këtë përbërje:

<u>Emri</u> <u>Po/Jo</u>	<u>Titulli</u>	<u>Rekomandimi i nënshkruar</u>
Konrad Wudtke	Drejtor	Po
Naser Peci	Udhëheqës i Departamentit të Gjeologjisë	Po
Selvete Grajcevc	Udhëheqëse e Divizionit Ligjor	Po

Blerim Jashari	Udhëheqës i Departamentit të Vëzhgimit	Po
Sami Duraku	Udhëheqës i Departamentit SIGJ	Po
Halit Gara	Udhëheqës i Divizionit të Hyrave	Po

Ky rekomandim pozitiv është mbështetur më tej nga një raport i mëhershëm gjeologjik mbi një vizitë në terren të bërë nga KPMM më 9 shkurt 2006. Ekipi i Gjeologjisë, i përbërë nga Udhëheqësi i Departamentit të Gjeologjisë, Burimet Kryesore të lëmisë së gjeologjisë dhe Zyrtari për Minerale, e kishte vlerësuar pozitivisht programin për eksplorim të paraqitur nga KR sh.p.k..

Mbledhja e Bordit Drejtues të KPMM-së është mbajtur më 11 maj 2006. Bordi e kishte miratuar Licencën për Explorim për një periudhë prej dy vitesh me votim 5:0. KPMM kishte lëshuar licencën për Explorim për 7 qershor 2006, me datë fillimi më 1 qershor 2006. Departamenti i Vëzhgimit e kishte verifikuar zyrtarisht zonën e licencës më 1 qershor po ashtu.

### **Vëzhgimet / Vlerësimet**

Shqyrtimi i aplikacionit për licencën e Drazhnjes është bërë si çështje e praktikës së zakonshme të KPMM-së. Të gjitha departamentet përkatëse kanë qenë pjesë e procesit që ka çuar drejt rekomandimit pozitiv për Bordin e KPMM-së. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm është paraqitur nga KR sh.p.k. me përjashtim të një deklaratë që do të konfirmonte se aplikacioni për këtë licencë është konsistent me Planin për Menaxhimin e Burimeve Minerale (pika 4.17 formulari i aplikimit që kërkohet me Nenin 21.e.5 të Rregullores 2005/3), meqë ky PMBM nuk ekziston. Shih paragrafin e fundit nën këtë nen për ta shqyrtuar më tej këtë kërkesë në kombinim me Nenin 61.2 të Rregullores.

Jemi informuar se KR sh.p.k. ishte aplikuesi i parë dhe i vetëm për këtë licencë dhe meqë të gjitha kërkesat përkatëse janë përmbushur dhe kësaj kompanie i është bërë një vlerësim pozitiv nga funksionet teknike të KPMM-së, pritej që të jepej dhe miratimi nga Bordi si dhe që licenca të lëshohej në vijim.

Nuk ka pasur njohuri për një aplikim aktual për licencë nga Trepça, po ashtu Trepça asnjëherë nuk ka pohuar të ketë paraqitur aplikacion për zonën e Drazhnjes. Është e rëndësishme të ceket se Trepça ka aplikuar në të kaluarën për licensa në zona tjera. Jemi informuar se Trepça nuk i ka dorëzuar KPMM-së ndonjë dokument që do të paraqiste bazë ligjore për të pretenduar pronësi apo të drejta ekskluzive mbi zonën e Drazhnjes.

Më 9 mars 2006 Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës kishte nxjerrë Vendim Moratoriumi për riorganizimin e Trepçës nën Administrimin e AKM-së, ku Crpulja dhe Drazhnja nuk përmenden si pasuri të Trepçës. Megjithatë, Minierat NPSH dhe Flotacioni Kishnica paraqiten si pronë e Trepçës, e cila është relevante në diskutimin mbi pronësinë dhe të drejtat.

Në dokumentacionin e aplikimit për Drazhjen, parcelat në zonën kadastrale Hertice në pronë të Kishnicës paraqiten në listën e posedimit. Më 20/02/1984 Minierat NPSH dhe Flotacioni Kishnica i ka kërkuar Kuvendit Komunal të Podujevës që të shpronësojë parcelat nga pronarët e tokave me qëllim që t'i mundësohet Kishnicës shfrytëzimi i minierave në atë zonë. Më 28/02/1984 Kuvendi Komunal kishte marrë vendim në favor të Minierave NPSH dhe Flotacioni Kishnica. Megjithatë, Zyra Ligjore e Shtyllës IV vlerëson se as kërkesa nga Minierat NPSH dhe Flotacioni Kishnica, dhe as vendimi i Kuvendit Komunal të Podujevës nuk mund të konsiderohen si e drejtë apo titull për shfrytëzim minierar apo edhe si dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit minierar sipas Ligjit Jugosllav për Shfrytëzimin Minierar, të shpallur më 25 qershor 1980.

Licenca e Drazhnjes në fakt përfshin një zonë të vogël në zonën kadastrale të Hertices. Me qëllimit të adresimit të kësaj çështjeje Drejtori i KPMM-së më 21 shkurt 2007 i kishte parashtruar AKM-së një propozim për zgjidhjen e çështjes së Drazhnjes në të cilën thuhet që “KR sh.p.k. do të kompensojë Trepçën nën Administrimin e AKM-së në një mënyrë adekuate për dëmet dhe çfarëdo ndikimesh të tjera përkatëse në pronën e Trepçës që mund të ndodhin gjatë realizimit të aktiviteteve të nevojshme të eksplorimit, në të njëjtën mënyrë si çdo pronar tjetër të sipërfaqes.” Ky propozim është dashur të finalizohet dhe të miratohet brenda një periudhe prej 3 javësh. KPMM na ka informuar se nuk kishin marrë kurrfarë përgjigje.

Sa i përket argumentit se KPMM është dashur të nxjerrë në tender këto zona për shkak të Neneve 17 1.a) dhe b), të Rregullores 2005/3, ne mendojmë se ky argument bazohet në keqinterpretim të përmbajtjes aktuale të Nenit dhe se Rregullorja në mënyrë të qartë bazohet në konceptin e “i pari që vjen shërbehet i pari” dhe se tenderët kërkohen vetëm për licensat e të ashtu-quajturave minerale “të energjisë”, gjë që thjesht nuk vlen për rastin e Drazhnjes, si dhe /apo në rastet kur autoriteti i përshtatshëm deklaronte nevojën për një tender të tillë, gjë që nuk vlen në këtë rast.

Dokumenti i Para-Bordit i nënshkruar nga gjithë pjesëtarët e stafit (vendor) si dhe dokumentacioni mbështetës i përgatitur në procesin e vlerësimit të aplikimit nga KR sh.p.k. nuk shfaq ndonjë indikacion për përfshirjen e Z. Valenta në këtë proces. Si njëri prej 5 anëtarëve të Bordit, Z. Valenta e ka miratuar lëshimin e licensës gjatë një vendimi të Bordit që ishte marrë me votë unanime dhe bazohet në këshillën që kishte rezultuar nga procesi i vlerësimit teknik i udhëhequr nga stafi tjetër (vendor) i KPMM-së. Fakti i dukshëm i mos përfshirjes së Z. Valenta në procesin e aplikimit krahas faktit se ka qenë muaji marsi 2007 kur Z. Valenta e ka pranuar postin e përkohshëm në KR sh.p.k., pothuajse një vit pasi KPMM kishte përmbyllur procesin e vlerësimit të brendshëm të aplikimit për licencë, e vë në dyshim pretendimin se një konflikt personal interesi i Z. Valenta mund të ketë ndikuar në favor të procesit administrativ të licencimit të KR sh.p.k. që në vitin 2006.

Nuk është gjetur bazë për pretendimin vijues se Z. Valenta do të mbante një post pronësie apo interesi tjetër të drejtpërdrejtë në kompaninë KR sh.p.k. KR sh.p.k. na ka informuar se këtë nuk e kanë pasur qëllim dhe nuk e kanë biseduar asnjëherë. Ne morëm një kopje të kontratës në mes të KR sh.p.k. dhe Z. Valenta, të nënshkruar në mars 2007, që

konfirmon në mënyrë të qartë se marrja në punë e Z. Valenta kishte si objektiv primar vetëm asistencën e përkohshme teknike. Z. Valenta është marrë në punë nga KR sh.p.k. në mars 2007, pasi kontrata e tij me Shtyllën IV të UNMIK-ut kishte skaduar në fund të vitit 2006, dhe e kishte lënë KR sh.p.k. në qershor 2007.

Në këtë mënyrë, në mungesë të ndonjë dëshmie konkrete në mbështetje të pretendimeve të përmendura më lart, argumentet që pretendojnë se procesi i licencimit nuk ka qenë i drejtë për shkak të një situatë të konfliktit të dyshuar të interesit si rezultat i postit të përkohshëm të Z. Valenta në një periudhë të mëvonshme në vitin 2007 në KR sh.p.k. del që nuk qëndrojnë.

Sa i përket argumentit të dhënë ne Mbledhjen e Kuvendit më 21 qershor 2007 mbi çështjen e mosdorëzimit nga KPMM-ja të Planit vjetor mbi Menaxhimin e Burimeve për Shfrytëzim Minerar (Neni 61.2 të Rregullores 2005/3) në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave (MEM), nuk e kuptojmë se si ky argument mund të ketë lidhje me dy procese individuale të licencimit, meqë sipas Rregullores 2005/3 autoritetin për të vlerësuar aplikimet dhe për të lëshuar licensat e ka vetëm KPMM-ja.

Për më tepër, duhet të vihet re se me Rregulloren 2005/3 as nuk i kërkohet KPMM-së t'i dorëzojë MEM-it MBSHM vjetor, as nuk përcakton afat për dorëzim. Zyra Ligjore e Shtyllës IV është e mendimit se Rregullorja e UNMIK-ut 2005/3 Neni 61 nuk paraqet justifikim ligjor për revokim të Aplikacioneve për Licencë të Drazhnjes e Crpuljes nga KPMM-ja, dhe nuk i jep as MEM-it autoritetin që të kërkojë anulimin e këtyre dy Licencave për Eksplorim. Një qasje e tillë e MEM-it do të përbënte gjithashtu një qasje mjaft arbitrare, duke pasur parasysh se MEM-i nuk ka shprehur kundërshtim në shumë raste të tjera ku Licencat për Eksplorim janë dhënë për minerale metalike, NPSH-së Trepça për shembull, Ndërmarrjes së Re Ferro Nikeli si dhe prodhuesit të Bakrit në SHBA Phelps Dodge.

## 2. Licenca e Crpuljes

Aplikacioni për licencën e Crpuljes nga KR sh.p.k. është marrë më 17 tetor 2006. Tarifa e përcaktuar është paguar përmes një banke lokale bashkë me dokumentacionin e kërkuar sipas Nenit 21 të Rregullores se UNMIK-ut 2005/3.

Më 30 dhjetor 2006, ekipi i ekspertëve të KPMM-së në mbledhjen e Para-Bordit vendosën që t'i rekomandonin Bordit të KPMM-së lëshimin e kësaj licence. Mbledhja e Para-Bordit ka pasur këtë përbërje:

<u>Emri</u> <u>nënshkruar Po / Jo</u>	<u>Titulli</u>	<u>Rekomandimi</u> <u>i</u>
Azem Rexhaj	Zëvendës Drejtor	Po
Selvete Grajceveci	Udhëheqëse e Divizionit Ligjor	Po
Naser Peci	Udhëheqës i Departamentit të Gjeologjisë	Po
Aqif Axhami	Udhëheqës i Departamentit të Vëzhgimit	Po
Sami Duraku	Udhëheqës i Departamentit SIGJ	Po

Halit Gara

Udhëheqës i Divizionit të Hyrave

Po

Ky rekomandim pozitiv është mbështetur më tej nga një raport i mëhershëm gjeologjik mbi një vizitë të bërë në terren nga KPMM më 14 nëntor 2006. Ekipi i Gjeologjisë, i përbërë nga Burimet Kryesore të lëmisë së Gjeologjisë, Gjeologu Kryesor i Planifikimit D dhe Zyrtari për Minerale, e kishte vlerësuar pozitivisht programin për eksplorim të paraqitur nga KR sh.p.k.

Mbledhja e Bordit Drejtues të KPMM-së është mbajtur 11 maj 2006. Bordi e kishte miratuar Licencën për Eksplorim për një periudhë prej dy vitesh me votim 5:0.

Mbledhja e Bordit Drejtues të KPMM-së është mbajtur më 4 janar 2007. Bordi e kishte miratuar që KR sh.p.k. t'i jepej Licenca e Crpuljes për Explorim për një periudhë prej dy vitesh me votim 4:0.

KPMM kishte lëshuar licencën për Explorim më 26 shkurt 2007, me datë fillimi më 23 shkurt 2007, datë në të cilën Departamenti i Vëzhgimit e kishte verifikuar zyrtarisht zonën e licencës po ashtu.

### **Vëzhgimet / Vlerësimet**

Shqyrtimi i aplikimit për licencën e Crpuljes është bërë si çështje e praktikës së zakonshme të KPMM-së. Të gjitha departamentet përkatëse kanë qenë pjesë e procesit që ka çuar drejt rekomandimit pozitiv për Bordin e KPMM-së.

KR sh.p.k. ishte aplikuesi i parë dhe i vetëm për këtë licencë dhe meqë të gjitha kërkesat përkatëse janë përmbushur dhe kësaj kompanie i është bërë një vlerësim pozitiv nga funksionet teknike të KPMM-së, pritej që dhe të miratohej nga Bordi dhe në vijim të jepej dhe licenca.

Nuk ka pasur njohuri për një aplikim aktual për licencë nga Trepça, po ashtu Trepça asnjëherë nuk ka pohuar të ketë paraqitur aplikacion për zonën e Crpuljes. Është e rëndësishme të ceket se Trepça ka aplikuar në të kaluarën për licenca në zona tjera (jo në Crpuljes). Jemi informuar se Trepça nuk i ka dorëzuar KPMM-së dokumente që do të paraqisnin bazë ligjore për të pretenduar pronësi apo të drejta ekskluzive mbi zonën e Crpuljes.

Jemi informuar se arsyet për lëshimin e licencës vetëm në fund të shkurtit 2007, edhe pse licenca ishte miratuar nga Bordi që në fillim të janarit 2007, kanë qenë që t'i mundësohej Trepçës që të paraqiste pretendime të bazuara për pronësinë dhe/apo të drejtat ekskluzive mbi zonën e Crpuljes.

Letra e Trepçës e 14 Nëntorit 2006 vetëm tregon që Trepça herë pas here ndërmernte aktivitete eksplorimi, dhe aktivitetet e ndërmarra së fundmi datojnë që në vitet e 1970-ta, gjë që nuk paraqet bazë të mjaftueshme ligjore që të pretendohet për të drejta të tanishme ekskluzive

Sa i përket situatës së pretenduar për konflikt interesi në lidhje me njërin nga anëtarët e Bordit të KPMM-së, Z. Alexander Valenta, është e nevojshme të vihet re se në kohën kur Bordi kishte miratuar licencën Crpuljes në fillim të vitit 2007 Z. Valenta nuk bënte më pjesë në organizatën e KPMM-së apo në Bordin e saj Drejtues.

### **3. Të gjeturat rreth licencave të Drazhnjes dhe Crpuljes**

#### **E gjetura 1. Përdorimi i Qarkores për shqyrtimin administrativ të kërkesave për licencim**

Kemi vërejtur se Qarkorja e përdorur për procesimin administrativ të kërkesës për licencë jo gjithmonë përmban datën e nënshkrimit nga të gjithat departamentet përkatëse si dhe nuk identifikon qartë se kur departamentet përkatëse e kanë kryer veprimin e tyre në procesin e shqyrtimit të aplikacionit.

#### **E gjetura 2 Përshkrimi i proceseve administrative**

KPMM-së i mungon një përshkrim i detajuar dhe gjithëpërfshirës i të gjithë hapave të procesit administrativ që duhet të ndërmerren që nga momenti i marrjes së një aplikimi deri në momentin e lëshimit të licencës. Sipas të kuptuarit tonë KPMM-së ende i mungon një manual administrativ në të cilin do të përshkruheshin hollësisht të gjitha proceset kyçe si ato financiare, administrative, të rekrutimit të stafit, të licencimit etj.

## **VI. Konkluzioni**

Të dyja proceset e licencimit të Drazhnjes dhe Crpuljes janë realizuar si çështje të praktikës së zakonshme të KPMM-së. Aplikimet janë bërë në pajtim me Rregulloren 2005/3 Neni 21 dhe aplikuesi KR sh.p.k. ka paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Anëtarët e Para-Bordit i kanë dhënë rekomandim pozitiv Bordit Drejtues për të dyja rastet dhe Bordi Drejtues ka marrë vendime unanime për dhënien e këtyre licencave. Mbledhja e Para-Bordit thirret nga pjesëtarët e stafit të KPMM-së të disiplinave përkatëse teknike dhe në të nuk përfshihen anëtarët e Bordit Drejtues me të drejtë vote. Nuk ka pasur bazë për të konstatuar si të vërteta pretendimet se këto procese të licencimit kanë qenë të njëanshme dhe të manipuluar në favor të kompanisë KR sh.p.k., dhe ne nuk kemi gjetur indikacione për ndonjë favoritizëm të tillë të dyshuar.

Sa i përket argumentit të parashtruar në Mbledhjen e Kuvendit më 21 qershor 2007 mbi çështjen e mosparaqitjes nga KPMM-ja të Planit vjetor për Menaxhimin e Burimeve për Shfrytëzimin Minerar (Neni 61.2) në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, ne kemi mendim të njëjtë me zyrën Ligjore të Shtyllës IV se kjo nuk ka ndikim në validitetin e dy licencave të lëshuara nga KPMM.

## **VII. Rekomandimet**

Më poshtë radhisim disa rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve administrative të licencimit në KPMM. Këto synojnë përmirësimin e mëtejshëm të

procese administrative dhe të regjistrimit në KPMM, por këto të gjetura nuk kanë ndikim në validitetin e dy proceseve të veçanta të licencimit të cilat janë trajtuar në këtë raport të auditimit.

### **Rekomandimi 1**

Me qëllim që të ketë evidentim më të qartë të afatit dhe gjurmës së auditimit që ka çuar drejt rekomandimit të Para-Bordit për Bordin Drejtues, ne rekomandojmë që Qarkorja duhet gjithmonë të përmbajë datën e nënshkrimit nga të gjitha departamentet përkatëse dhe të tregojë se kur është kryer secili hap i procesit nga secili prej departamenteve përkatëse.

### **Rekomandimi 2**

Rekomandojmë që KPMM të hartojë një “Manual administrativ” për proceset e saj kryesore financiare, administrative, i cili do të përcaktonte qartë hapa të hollësishëm si dhe të përshkruante qartë përgjegjësitë dhe nivelet e autoritetit të stafit të angazhuar. Ky Manual Administrativ duhet të përmbajë sa vijon, por sigurisht nuk kufizohet vetëm me këto:

- Procesin e licencimit për Licencën e Eksplorimit
- Procesin e licencimit për Licencën e Shfrytëzimit Minerar
- Procesin e faturimit, duke përfshirë përpjekjet për barazim me qëllim që të garantohet plotësia e faturimit
- Procesin e faturimit dhe arkëtimit të taniemave, duke përfshirë verifikimin e sasive të shfrytëzimit minerar
- Procesin e prokurimit dhe zbatimin praktik të Ligjit të Prokurimit Publik

## **VIII. Komentet e KPMM**

KPMM iu ka dhënë mundësi për dhënien e komenteve në draft raportin e auditimit në mënyrë që të eliminohet rreziku i keqinterpretimit dhe keqkuptimit . KPMM është pajtuar me rekomandimet e tona prandaj drafti është bërë final i njëjti.